

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkontinentale e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Inxhinier Projektues ne Infrastruktura

❖ DETYRAT KRYESORE

- Përgjegjës për organizimin e punës për detyrën e projektimit për projektet e realizuara nga të tretë;
- Aftësi organizative, menaxhimi dhe planifikimi, përfshi aftësinë për të kryer disa punë njëherazi;
- Bashkpunim i ngushtë me ekipin e profesionistëve të tjera, si inxhinierë, menaxherë të fushës së ndërtimit;
- Kryen rol teknik, organizativ dhe supervisor per projektet ne ndertim;
- Harton gjithe dokumentacionin e nevojshem te objekteve te planikuara per tu ndertuar nga kompania;
- Kontrollon, vlerëson & rishikon projektet nga ana tekniqe;
- Përgjegjës për dhënien e zgjidhjeve teknike në lidhje me punimet inxhinierike si dhe hartimin e raporteve teknike Përgjegjës për pregetitjen e plan organizimit të punimeve;
- Përgjegjës për pregetitjen e metodikave te ndryshme te punimeve per punimet civile per fazen e tenderit dhe zbatimit;
- Përgjegjës për raportimin favor per sherbimet e kryera tek eprori;
- Përgjegjës për analizimin e problematikave nga kantieri dhe dhënien e zgjidhjes/ve teknike optimale;
- Kryen vlerësimin e zgjidhjeve teknike nga palë të treta dhe propozon përmirësimë;
- Rishikimin e specifikimeve teknike, pregetitjen e tyre nese eshte e nevojshme;
- Merr pjesë në vlerësimin teknik të ofertave në procedura prokurimi ose tendera;
- Projektimin e projekteve te vogla duke perfshire gjithe elementet si: Vizatimet e detajuara, raportet etj.

❖ KRITERET KRYESORE

- Inxhinieri Ndertimi. Strukturist ose Infrastruktura
- Mbi 5 vite eksperience ne Projektim dhe Zbatim godinash dhe infrastrukture;
- Aftesi te shkelqyera komunikimi ne Shqip dhe Anglisht (gjuhet shtese jane plus);
- Aftesi per te punuar dhe organizuar punen ne grup (shume e rendesishme);
- Aftesi per te punuar pa supervizim;
- Aftesi raportuese

Te gjithe te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 01 Shtator 2023**, ora 17:00.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënavë personale”.